



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 50

2001

Nëntor

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.564, datë 13.10.2001	Për kuotat financiare të ushqimit në mençat e konvikteve, bursat e shtetit dhe pagesat e familjeve të nxënësve, studentëve dhe fëmijëve që prahen në shtëpitë e fëmijës, në Institutin e fëmijëve që nuk dëgjojnë e nuk shikojnë dhe në Institutin e fëmijëve me prapambetje të lehtë mendore 1599
Vendim i KM nr. 571, datë 22.10.2001	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i varrezave publike në komunën Gjegjan, Pukë 1605
Vendim i KM nr. 572, datë 22.10.2001	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Librazhdit 1606
Vendim i KM Nr. 573, datë 22.10.2001	Për një ndryshim në vendimin nr. 83, datë 26.2.2001 të Këshillit të Ministrave "Për tarifatat telefonike dhe për pagesat elektrike nga personat me aftësi të kufizuar" 1607

Vendim i KM nr. 574, datë 22.10.2001	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Bajram Currit	1607
Vendim i KM nr. 575, datë 22.10.2001	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Shkodrës	1608
Vendim i KM nr. 577, datë 22.10.2001	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Vorës	1609
Vendim i KM nr. 578, datë 22.10.2001	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Poliçanit	1610
Vendim i KM nr. 579, datë 22.10.2001	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Pukës	1611
Vendim i KM nr. 581, datë 22.10.2001	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Çorovodës	1612
Vendim i KM nr. 602, datë 2.11.2001	Për çmimet tavan të shitjes së energjisë elektrike për përdoruesit familjarë dhe jofamiljarë	1613
Vendim i KM nr. 603, datë 2.11.2001	Për disa shtesa në vendimin nr. 479, datë 31.8.2000 të Këshillit të Ministrave “Për përgatitjen dhe realizimin e kontratës së koncensionit për ndërtimin e terminalit të ri të pasagjerëve në Aeroportin e Rinasit”	1614
Vendim i KQZ nr.166, datë 12.7.2001	Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zonës zgjedhore nr.29	1614
Vendim i KQZ nr.197, datë 24.7.2001	Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zonës zgjedhore nr.22	1615
Vendim i KQZ nr.198, datë 24.7.2001	Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zonës zgjedhore nr.86	1615
Vendim i KQZ nr.203, datë 25.7.2001	Për shpalljen e rezultatit të zonës zgjedhore nr.2	1616
Vendim i KQZ nr.213, datë 2.8.2001	Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zonës zgjedhore nr.4	1616
Vendim i KQZ nr.215, datë 4.8.2001	Për shpalljen e rezultatit për votimet për deputetë të listave shumëmerore për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001.....	1617

Vendim i KQZ nr.217, datë 7.8.2001	Për shpalljen e rezultatit të zonës zgjedhore nr.14	1619
Vendim i KQZ nr.226, datë 20.8.2001	Për shpalljen e rezultatit të zonës zgjedhore nr.82	1620
Vendim i KQZ nr.227, datë 21.8.2001	Për numrin e vendeve që u përkasin partive politike dhe koalicioneve nga ndarja e mandateve plotësuese në zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001	1621
Vendim i KQZ nr.228, datë 21.8.2001	Për shpalljen e listës së deputetëve të Partisë Socialdemokrate, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001.....	1623
Vendim i KQZ nr.229, datë 21.8.2001	Për shpalljen e listës së deputetëve të Partisë Aleanca Demokratike, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001.....	1624
Vendim i KQZ nr.230, datë 21.8.2001	Për shpalljen e listës së deputetëve të Partisë Demokrate, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001.....	1625
Vendim i KQZ nr.231, datë 21.8.2001	Për shpalljen e listës së deputetëve të Partisë Agrare të Shqipërisë, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001.....	1626
Vendim i KQZ nr.232, datë 21.8.2001	Për shpalljen e listës së deputetëve të koalicionit politik “Bashkimi për Fitore”, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001	1628
Vendim i KQZ nr.233, datë 21.8.2001	Për shpalljen e listës së deputetëve të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001.....	1630
Vendim i KQZ nr.256, datë 17.10.2001	Për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për kryetarin e komunës së Golajt të Qarkut të Kukësit	1631
Vendim i KKRT nr. 51, datë 16.7.2001	Për dhënie licence	1632
Vendim i KKRT nr. 53, datë 16.7.2001	Për dhënie licence	1633
Vendim i KKRT nr. 54. datë 16.7.2001	Për dhënie licence	1633

V E N D I M
Nr.564, datë 13.10.2001

PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENCAT E KONVIKTEVE, BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E FAMILJEVE TË NXËNËSVE, STUDENTËVE DHE FËMIJËVE QË PRANOHEN NË SHTËPITË E FËMIJËS, NË INSTITUTIN E FËMIJ ËVE QË NUK DËGJOJNË E NUK SHIKOJNË DHE NË INSTITUTIN E FËMIJËVE ME PRAPAMBETJE TË LEHTË MENDORE

PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENCAT E KONVIKTEVE, BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E FAMILJEVE TË NXËNËSVE, STUDENTËVE DHE FËMIJËVE QË PRANOHEN NË SHTËPITË E FËMIJËS, NË INSTITUTIN E FËMIJËVE QË NUK DËGJOJNË E NUK SHIKOJNË DHE NË INSTITUTIN E FËMIJËVE ME PRAPAMBETJE TË LEHTË MENDORE.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të nenit 7 të ligjit nr.8718 datë 19.12.2000 "Për buxhetin e shtetit, të vitit 2001", të shkronjës "c" të nenit 32 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995, "Për sistemin arsimor parauniversitar", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Nxënësve dhe studentëve u jepet bursë ose gjysmë bursë, çdo vit, sipas parashikimit vjetor të Buxhetit të Shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

2. Bursë ose gjysmëbursë përfitojnë:

a) nxënësit dhe studentët që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrave nr.1 dhe nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi;

b) nxënësit që banojnë në fshat, të cilët nuk kanë ndonjë shkollë 8-vjeçare brenda rrezes prek 5 km dhe transport të garantuar, e që vendosen në konvikt;

c) nxënësit dhe studentët jetimë, që përfitojnë të gjitha të drejtat që u jep ligji për jetimët, në të gjitha kategoritë e shkollave;

ç) studentët e divorcuar;

d) secili nga studentët bashkëshortë, që ka fëmijë;

dh) nxënësit dhe studentët, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë.

Nxënësit dhe studentët jetimë, studentët e divorcuar, nxënësit dhe studentët e braktisur që trajtohen me bursë ose gjysmëbursë, e përfitojnë atë dhe gjatë pushimeve verore. Bursa ose gjysmë bursa gjatë pushimeve të jepet nga institucioni arsimor përkatës me lekë në dorë;

e) studentët që vazhdojnë studimet në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, në degët matematikë, fizikë, si dhe ata studentë që kanë përfituar bursë sipas këtij kriteri, të trajtohen me bursë deri në përfundim të studimeve, jashtë kriterit ekonomik.

Për këtë kategori studentësh, bursat të shpërndahen nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, sipas planit të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të kuotave të pranimit të miratuara nga Këshilli i Ministrave, për këto degë.

ë) Nxënësit, në arsimin e mesëm profesional, që kanë mbaruar vitin shkollor paraardhës me të gjitha notat 10-ta marrin bursë të plotë.

f) Studentët që kanë mbaruar vitin akademik paraardhës me të gjitha notat 10-ta, marrin bursë të plotë.

g) Studentët e viteve të dyta e lart që plotësojnë kriteret ekonomike, jashtë bursave të ndërmjetme, marrin bursë nga universitetet, me miratimin e drejtorisë ekonomike pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Numri i bursave, për këtë qëllim është deri në 100, sipas planit të shpërndarjes, të hartuar nga kjo drejtori për të gjitha universitetet, brenda numrit të bursave të vitit të parë, të miratuara me këtë vendim.

gj) Pedagogët, punonjësit pedagogjikë e kërkimorë, që kryejnë kualifikim shkencor, në mbështetje të vendimit nr.786, datë 17.12.1998, të Këshillit të Ministrave.

Kjo kategori përfiton çdo të drejtë që gëzojnë studentët. Plani për këtë kategori bursistësh të jetë jo më shumë se 10 bursa, brenda planit të vitit të parë. Shpërndarja e këtyre bursave të bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencave.

3. Bursë dhe gjysmëbursë nuk përfitojnë:

a) nxënësit dhe studentët e familjeve, që ushtrojnë veprimtari private, sipas dispozitave ligjore në fuqi;

b) nxënësit dhe studentët e ndarë nga trangu familjar. Për efekt trajtimi me bursë, merren për bazë të ardhurat ekonomike të të gjithë familjes nga e cila është ndarë dhe certifikata familjare para ndarjes;

c) më shumë se një person në familje, përveç rasteve të parashikuara në shkronjat "ç", "d", "dh" dhe "f", të pikës 2 të këtij vendimi;

ç) nxënësit e shkollave 8 vjeçare, të mesme dhe studentët që nuk fitojnë klasën apo vitin.

4. Studentët, pavarësisht nga kriteret, nuk mund të përfitojnë bursë ose gjysmëburse më tepër se vitet e shkollimit, të përcaktuara në planin mësimor për degën përkatëse.

5. Këshillat e qarkut, me propozimin e këshillave të komunave dhe të bashkive kanë të drejtë të miratojnë bursë ose gjysmë bursë jashtë kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, brenda planit të vitit të parë, ku për çdo rreth planifikohen jo më shumë se 3 bursa. Këshilli bashkiak i Tiranës ka të drejtë të japë deri në 30 bursa. Këto bursa duhet të kundërfirmosen, për efekt plani, nga drejtori i drejtorisë arsimore në rreth.

Nxënësi dhe studenti e përfiton këtë bursë për gjatë gjithë viteve të planifikuara të shkollimit. Në rastet kur nxënësi ose studenti që përfiton këtë lloj burse, ndërpret shkollën për arsye të ndryshme, i humbet e drejta e kësaj burse.

6. Bursistët jetimë të shtëpive të fëmijës dhe të shkollave të mesme e të larta, nxënësit e institutit të fëmijëve që nuk shikojnë dhe që nuk dëgjojnë, si dhe emigrantët politikë përfitojnë falas veshmbathje, libra, fletore, sipas normave të përcaktuara në natyrë, sipas pasqyrës nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Këto kategori nxënësish përfitojnë falas nga shteti, shërbimin mjekësor, në kuotën deri në 200 lekë në muaj për nxënës, si dhe shërbimin shëndetësor dentar.

Kuota e ushqimit dhe shpenzimeve të vogla, për nxënësit e institucioneve të arsimit special, me konvikt, të jetë sipas pasqyrës 5/1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Fëmijët e insitucioneve, të arsimit special, pa konvikt, trajtohen falas nga shteti me një vakt ushqimi (drekë) dhe me mjete shkollore. Kuota ushqimore, për këtë kategori nxënësish, të jetë 70 lekë në ditë.

Mësuesit dhe edukatorët e institucioneve të mësipërme, gëzojnë të drejtën e një vakti (drekë), me vlerë deri në 70 lekë në ditë. Kuota financiare ushqimore, ditore, për studentin të jetë sipas pasqyrës nr.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Nxënësve dhe studentëve jetimë, bursistë, u jepen lekë në dorë për nevoja vetjake, përkatësisht 500 dhe 700 lekë në muaj. Këtë të drejtë e gëzojnë dhe kur kurohen në institucionet shëndetësore.

7. Niveli i bursave dhe i kuotave financiare të ushqimit për të gjitha kategoritë e shkollave, të jetë sipas pasqyrave nr.3 dhe nr.4, "Për nivelin e bursave dhe të kuotave financiare ditore", që i bashkëlidhen këtij vendimi. Kuota ushqimore për nxënësit dhe studentët në lekë të jetë sipas pasqyrës nr.6 dhe kuota financiare në natyrë, për ushqim, e studentëve të jetë sipas pasqyrës nr.7, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Për ata nxënës ku konviktet nuk funksionojnë si pasojë e shkatërrimeve të vitit 1997 bursa u jepet me lekë në dorë.

Bursa e plotë dhe gjysmëbursa për studentët jepet me lekë në dorë.

8. Nxënësve dhe studentëve u ruhet bursa, kur humbasin vitin shkollor apo akademik për arsye shëndetësore ose fatkeqësi familjare.

9. Kur institucioni arsimor kryen zyrtarisht transferimin e së drejtës së studimit, bashkë me të transferon edhe planin e bursës që ka gëzuar studenti. Transferimi i bursës së nxënësit bëhet me miratimin e drejtorisë ekonomike pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Bursa dhe gjysmëbursa për vitet e para të shkollave 8-vjeçare, të mesme dhe të larta

miratohet me vendim të këshillit bashkiak apo të komunës, ku ka vendbanimin e përhershëm nxënësi apo studenti.

10. Drejtoritë arsimore në rrethe bëjnë shpërndarjen e planit të bursave, duke përfshirë edhe bursat jashtë kriterit, që miratohen nga këshillat e qarqeve apo nga këshilli bashkiak i Tiranës, brenda planit të vitit të parë.

Bursat ose gjysmëbursat për nxënësit dhe studentët e të gjitha niveleve për vitet e para të kundërfirmosen, për efekt plani, nga drejtori i drejtorisë arsimore të rrethit, në përputhje me planin e dërguar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Drejtoritë arsimore mbajnë një kopje të vendimit dhe dërgojnë një kopje të listës së nxënësve dhe studentëve bursistë, në shkolla apo universitete dhe një kopje pranë Drejtorisë Ekonomike të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Bursa e studentëve të vitit të parë të shpërndahet vetëm pasi të jenë dërguar zyrtarisht listat nga drejtoritë arsimore të rretheve.

Bursat ose gjysmëbursat për nxënësit dhe studentët e viteve të dyta e lart të rishqyrtohen e miratohen nga vetë shkollat dhe universitetet ose nga institucionet përkatëse.

11. Të drejtat që nxënësit dhe studentët përfitojnë sipas këtij vendimi i gëzojnë nga data e fillimit të vitit të ri shkollor apo akademik e deri në përfundim të tij, duke përfshirë dhe sezonin e provimeve. Në periudhën e pushimeve verore nxënësit dhe studentët nuk përfitojnë bursë ose gjysmë bursë, përveç rasteve të parashikuara në këtë vendim.

12. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për vitin shkollor dhe akademik 2001-2002, i jepen 900 bursa për arsimin e mesëm dhe 1100 bursa për arsimin e lartë.

13. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave nga viti i dytë e lart, për të gjitha kategoritë e shkollave, të jetë data 30 tetor 2001.

14. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për arsimin e lartë, të vitit të parë, të jetë data 30 nëntor 2001.

Çdo shqyrtim dhe miratim jashtë këtij afati përbën shkelje të disiplinës financiare si për organin miratues, ashtu dhe për atë pranues.

Personat përgjegjës ngarkohen të zhdëmtojnë shumat e marra padrejtësisht, me propozimin e organit të kontrollit dhe me miratimin e titullarit të institucionit qendror, duke ndërprerë menjëherë dhënien e mëtejshme të kësaj burse.

15. Kuotat financiare të ushqimit në menca rriten nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, në varësi nga idenksimi i çmimeve të konsumit, por jo më shumë se një herë në gjashtë muaj.

Efektet financiare që rrjedhin nga idenksimi i kuotës financiare të ushqimit të përballohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

16. Çdo vendim apo udhëzim për bursën, kuotën ushqimore, veshmbathjen dhe shpenzime të tjera për nxënësit, nxënësit e arsimit special e jetimët dhe studentët, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Illir Meta

Kushtet ekonomike të nxënësit për dhënien e bursës

PASQYRA NR. 1

Në lekë

Nr	Përbërja familjare	Të ardhurat për frymë në familjet e nxënësve		
		Bursa	Gjysmëbursa	Me pagesë
1	Për familjet me 2 persona	1550	1550-2650	mbi 2650
2	Për familjet me 3 persona	1350	1350-2350	mbi 2350
3	Për familjet me 4 persona	1250	1250-2300	mbi 2300

4	Për familjet me 5 persona	1150	1150-2200	mbi 2200
5	Për familjet me 6 persona	1050	1050-2145	mbi 2145
6	Për familjet me 7 persona	1000	1000-2100	mbi 2100
7	Për familjet mbi 7 persona	900	900-2000	mbi 2000

Shënim: Nxënësit nga fshati përfitojnë bursë të plotë, kur familja fshatare përfiton ndihmë ekonomike të plotë dhe 70 për qind të bursës së plotë, kur familja fshatare përfiton ndihmë ekonomike të pjesshme, të tjerët me pagesë.

Kushtet ekonomike të studentit për dhënien e bursës

PASQYRA NR.2

Në lekë

Nr	Përbërja familjare	Të ardhurat për frymë në familjet e nxënësve		
		Bursa	Gjysmëbursa	Me pagesë
	Për qytetin			
1	Për familjet me 2 persona	1980	1980-3190	mbi 3190
2	Për familjet me 3 persona	1760	1760-2860	mbi 2860
3	Për familjet me 4 persona	1650	1650-2800	mbi 2800
4	Për familjet me 5 persona	1485	1485-2750	mbi 2750
5	Për familjet me 6 persona	1375	1375-2673	mbi 2673
6	Për familjet me 7 persona	1300	1300-2596	mbi 2596
7	Për familjet mbi 7 persona	1254	1254-2486	mbi 2486

Shënim: Studentët nga fshati përfitojnë bursë të plotë, kur familja fshatare përfiton ndihmë ekonomike të plotë dhe 70 për qind të bursës së plotë, kur familja fshatare përfiton ndihmë ekonomike të pjesshme, të tjerët me pagesë.

Niveli i bursës dhe i kuotës ushqimore për studentin

PASQYRA NR.3

Në lekë

Nr	Kategoritë e studentëve sipas shkollave	Bursa	Mënyra e mbulimit		Mënyra e shpenzimit		Fjetja	
			Nga Buxheti	Nga studenti	Ushqimi Nga Buxheti	Nga studenti	Nga Buxheti	Nga studenti
1	Universitetet, Akademia e Arteve dhe Shkolla e Lartë e Infermierisë							
	Bursa	7200	7200		6500		700	
	Gjysmëbursa	7200	3600	3600	3250	3250	350	350
	Me pagesë			7200		6500		700
2	Studentë të ILKF "Vojo Kushi"							
	Bursa	7800	7800		7100		700	
	Gjysmëbursë	7800	3900	3900	3550	3550	350	350
	Me pagesë			7800		7100		700

Shënim: Pagesa për fjetjen e studentëve në konvikt caktohet nga MASH-i, por jo më pak se niveli i përcaktuar në këtë pasqyrë.

Pagesa e fjetjes për pedagogët dhe specializantët të jetë 2000 lekë për dhomë.

Niveli i bursës dhe i kuotës ushqimore për nxënësin

PASQYRA NR.4

Në lekë

Nr	Kategoritë e nxënësve sipas shkollave	Bursa	Mënyra e mbulimit		Mënyra e shpenzimit	
			Nga Buxheti	Nga nxënësi	Ushqimi	Shpenz. të vogla
1	Shkolla 8-vjeçare e të mesme					
	Bursa	4500	4500		4350	150
	Gjysmëbursa	4500	2250	2250	4350	150
	Me pagesë			4350	4350	
2	Shkolla e Mjeshtërisë Sportive					
	Bursa	4950	4950		4800	150
	Gjysmëbursë	4950	2475	2475	4800	150
	Me pagesë			4800	4800	
3	Shkolla e Futbollit					
	Bursa	5650	5650		5500	150
	Gjysmëbursë	5650	2825	2825	5500	150
	Me pagesë			5500	5500	

Kuotat financiare të veshmbathjes

PASQYRA NR.5

Në lekë

Nr	Emërtimi	Kuotat financiare të veshmbathjes për një vit kalendarik
1	Për fëmijët e shtëpisë të moshës para shkollore	5000
2	Për fëmijët e shtëpisë të moshës shkollore dhe të institucioneve të nxënësve që nuk dëgjojnë, nuk flasin dhe nuk shikojnë	7000
3	Për jetimët e shkollave të mesme dhe të larta	10000

Niveli i bursës dhe i kuotës ushqimore për nxënësin e arsimit special

PASQYRA NR.5/1

Në lekë

Nr	Kategoritë e nxënësve sipas shkollave	Bursa	Mënyra e mbulimit		Mënyra e shpenzimit	
			Nga Buxheti	Nga nxënësi	Ushqimi	Shpenz. të vogla
1	Nxënësit jetim dhe të insitucioneve speciale	5300	5300		5150	150

Kuota ushqimore ditore për nxënësiN dhe studentin

PASQYRA NR.6

Në lekë

1. Universitete, Akademia e Arteve dhe Shkolla e Lartë e Infermierisë 216.6 lekë në ditë.
2. Studentë të ILKF "Vojo Kushi" 236.6 lekë në ditë
3. Nxënës të shkollave tetëvjeçare dhe të mesme 145 lekë në ditë

Kuota financiare sipas normave në natyrë për ushqim të studentëve

PASQYRA NR.7

Nr	Emërtimi	Njësia e matjes	Norma mes.ditore	Çmimi mesatar	Vlera
1	Bukë	gram	600	66	39.6
2	Makarona	gram	30	88	2.64
3	Oriz	gram	30	88	2.64
4	Sheqere	gram	55	85	4.68
5	Fasule	gram	35	144	5.04
6	Patate	gram	200	60	12
7	Perime	gram	300	75	22.6
8	Fruta	gram	100	100	10
9	Vaj	gram	30	190	5.7
10	Gjalpë	gram	15	520	7.8
11	Mish	gram	100	600	60
12	Qumësht	gram	200	40	8
13	Djath	gram	40	350	14
14	Reçel	gram	40	250	10
15	Vezë	kokrra	1	10	10
16	Çaj, erëza etj.				1.9
	Kuota ditore				216.6

V E N D I M

Nr. 571, datë 22.10.2001

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË KOMUNËN GJEGJAN, PUKË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarit, që preket nga ndërtimi i varrezave publike, në komunën Gjegjan, Pukë.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të komunës Gjegjan, Pukë.
3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet, në vlerë të plotë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 1240 m² tokë, arë dhe truall, në shumën e përgjithshme prej 396 800 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind) lekësh.
4. Ky fond përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësimet", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.

5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të komunës Gjegjan, Pukë, kërkuesit për shpronësim, në shumën 138 000 (njëqindtridhjetë mijë) lekë.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 10 deri më 30 nëntor 2001.

7. PAGESA E PRONARIT TË SHPRONËSUAR TË KRYHET nga komuna Gjegjan, Pukë.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e qarkut të Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E
VARREZAVE PUBLIKE KOMUNA GJEGJAN (PUKË)

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera në lekë
1	Mark Nikollë Gjini	1240	320	396.800

V E N D I M
Nr. 572, datë 22.10.2001

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE
NË BASHKINË E LIBRAZHBIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarit, që preket nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Librazhdit.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Librazhdit.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet, në vlerë të plotë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 2100 m², tokë, arë, në shumën e përgjithshme prej 1 890 000 (një milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.

5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të Bashkisë së Librazhdit, kërkuesit për shpronësim, në shumën 138 000 (njëqind e tridhjetë e tetë mijë) lekë.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 10 deri më 30 nëntor 2001.

7. PAGESA E PRONARIT TË SHPRONËSUAR TË KRYHET nga Bashkia e Librazhdit.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E
VARREZAVE PUBLIKE BASHKIA LIBRAZHD

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m2	Çmimi lek/m2	Vlera në lekë
1	Enver Bilal Mana	2100	900	1.890.000

V E N D I M
Nr. 573, datë 22.10.2001

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 83, DATË 26.2.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR TARIFAT TELEFONIKE DHE PËR PAGESAT ELEKTRIKE NGA
PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të nenit 12 të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", si dhe të nenit 38 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionin në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Pika 3 e vendimit nr.83, datë 26.2.2001 të Këshillit të Ministrave ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Çdo përdorues me aftësi të kufizuara, që ka përfutur statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik ose statusin e të verbërit, paguan 20 për qind të vlerës së konsumit mujor të energjisë elektrike."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, dhe i shtrin efektet që nga data e hyrjes në fuqi të vendimit nr. 83, datë 26.2.2001 të Këshillit të Ministrave.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 574, datë 22.10.2001

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË
E BAJRAM CURRIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarit, që preket nga ndërtimi i varrezave publike, në Bashkinë e Bajram Currit.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Bajram Currit.
3. Pronari i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet të kompensohet në vlerë të plotë, sipas

listës që i bashkëlidhet këtij vendimi për sipërfaqen prej 1430 m² tokë arë, në shumën e përgjithshme prej 854 997 (tetëqind e pesëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.

5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të Bashkisë së Bajram Currit, kërkuesit për shpronësim, në shumën 138 000 (njëqind e tridhjet e tetë mijë) lekë.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 10 deri më 30 nëntor 2001.

7. Pagesa e pronarit të shpronësuar të kryhet nga Bashkia e Bajram Currit.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Kukësit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Irir Meta

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E
VARREZAVE PUBLIKE BASHKIA BAJRAM CURRI

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera në lekë
1	Isa Male Mustafaj	1430	597,9	854997

V E N D I M
Nr. 575, datë 22.10.2001

**PËR SHPRONSËIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E
SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Shkodrës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Shkodrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi për sipërfaqen prej 20 000 m² tokë arë, në shumën e përgjithshme prej 9 600 000 (nëntë milionë e gjashtëqind mijë) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.

5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të Bashkisë së Shkodrës, kërkuesit për shpronësim, në shumën 115 000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 10 deri më 30 nëntor 2001.

7. Pagesa e pronarëve të shpronësuar të kryhet nga Bashkia e Shkodrës.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE BASHKIA SHKODËR

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m2	Çmimi lek/m2	Vlera në lekë
1	Vat Nik Boshi	1900	480	912000
2	Gjovalin Rrok Vukelaj	2600	480	1248000
3	Mark Mhill Pjetri	4000	480	1920000
4	Mhill Kolë Pjetri	2400	480	1152000
5	Fran Kolë Pjetri	4400	480	2112000
6	Ali Cuf Mehmetaj	4700	480	2256000
			Shuma	9600000

V E N D I M
Nr. 577, datë 22.10.2001

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E VORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

- Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarit që preket nga ndërtimi i varrezave publike, në Bashkinë e Vorës.
 - Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Vorës.
 - Pronari i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet të kompensohet në vlerë të plotë, sipas listës që i bashklidhet këtij vendimi për sipërfaqen prej 3 020 m2 tokë arë, në shumën e përgjithshme prej 3 020 000 (tre milionë e njëzet mijë) lekësh.
 - Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.
 - Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të Bashkisë së Vorës, kërkuesit për shpronësim, në shumën 96 000 (nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë.
 - Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 10 deri më 30 nëntor 2001.
 - Pagesa e pronarit të shpronësuar të kryhet nga Bashkia e Vorës.
 - Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E
VARREZAVE PUBLIKE BASHKIA VORË**

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m2	Çmimi lek/m2	Vlera në lekë
1	Hanke Mahmut Hasrama	3020	1000	3020000

**V E N D I M
Nr. 578, datë 22.10.2001**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E
POLIÇANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarëve që preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Poliçanit.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Poliçanit.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 2160 m2 tokë arë, në shumën e përgjithshme prej 1 188 000 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekësh.
 4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësim", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.
 5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të Bashkisë së Poliçanit, kërkuesit për shpronësim, në shumën 138 000 (njëqind e tridhjetë e tetë), lekë.
 6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 10 deri më 30 nëntor 2001.
 7. Pagesa e pronarëve të shpronësuar të kryhet nga Bashkia e Poliçanit.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Beratit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Ilir Meta**

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E
VARREZAVE PUBLIKE BASHKIA POLIÇAN**

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m2	Çmimi lek/m2	Vlera në lekë
1	Xhaferr Kasem Daja	1080	550	594 000
2	Zerdeli Kasem Kreku	1080	550	594 000
	Shuma	2160		1 188 000

V E N D I M
Nr. 579, datë 22.10.2001

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E PUKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve që preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Pukës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Pukës.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas listës që i bashklidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 2725 m2 tokë arë, në shumën e përgjithshme prej 872 000 (tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekësh.
 4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.
 5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të Bashkisë së Pukës, kërkuesit për shpronësim, në shumën 138 000 (njëqind e tridhjetë e tetë) lekë.
 6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 10 deri më 30 nëntor 2001.
 7. Pagesa e pronarëve të shpronësuar të kryhet nga Bashkia e Pukës.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Lista emërore e pronarëve që do të shpronësohen për ndërtimin e varrezave, publike të Bashkisë së Pukës

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m2	Çmimi lek/ m2	Vlera në lekë
1	Halil Mus Laçi	1413	320	452160
2	Sherif Osman Laçi	1090	320	348800
3	Hamit Kapllan Laçi	222	320	71040
	Shuma	2725		872 000

V E N D I M
Nr. 581, datë 22.10.2001

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E
ÇOROVODËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarit që preket nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Çorovodës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Çorovodës.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet të kompensohet në vlerë të plotë, sipas listës që i bashklidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 2040 m² tokë arë, në shumën e përgjithshme prej 1 224 000 (një milion e dyqind e njëzet e katër mijë) lekësh.
 4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.
 5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të Bashkisë së Çorovodës, kërkuesit për shpronësim, në shumën 138 000 (njëqind e tridhjetë e tetë) lekë.
 6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 10 deri më 30 nëntor 2001.
 7. Pagesa e pronarit të shpronësuar të kryhet nga Bashkia e Çorovodës.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Beratit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

Lista emërore e pronarëve që do të shpronësohen për zgjerimin e varrezave publike Bashkia E Çorovodës

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera në lekë
1	Virgjil Myrsel Koprencka	2040	600	1 224 000

V E N D I M

Nr. 602, datë 2.11.2001

PËR ÇMIMET TAVAN TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PËRDORUESIT FAMILJARË DHE JOFAMILJARË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "b" të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr.7970, datë 20.7.1995 "Për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike", me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministrisë të Shtetit për Energjetikën, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Çmimet tavan të shitjes së energjisë elektrike për përdoruesit familjarë, specialë dhe të tjerë të jenë sipas tabelës që i bashklidhet këtij vendimi.
 2. Pika 2 e vendimit nr.137, datë 31.3.1994 të Këshillit të Ministrave, vendimi nr.743, datë 18.12.1995 i Këshillit të Ministrave, vendimi nr.564, datë 23.10.2000 i Këshillit të Ministrave dhe vendimi nr.106, datë 2.3.2001 i Këshillit të Ministrave shfuqizohen.
 3. Ngarkohen Enti Rregullator i Energjisë, KESH sh.a., "Elektriku Elbasan" sh.a., "Elektriku Vlorë" sh.a. dhe "SESA Shkodër" sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

Nr.	EMËRTIMI	Çmimi
		lekë/kWh
A	Përdorues familjarë	
	300 kWh e para të muajit	4.0
	Mbi 300 kWh e para të muajit	8.0
B	Përdorues specialë	
	Furra buke	6.0
	Ujësjiellësa, objekte fetare	6.0
	Buxhetorët	8.0
	Nafta, kromi, bakri, siderurgjia, gjeologjia	8.0
C	Përdorues të tjerë	
	Furnizimi nga rrjeti TL (35 dhe 110 kV)	9.0
	Furnizimi nga rrjeti TM (6,10 dhe 20 kV)	10.0
	Furnizimi nga rrjeti TU	12.0

Shënim: Energjia e përdorur për mjediset e përbashkëta (ndriçim shkalle, ashensor, pompë uji) do të faturohet me 4 lekë.

V E N D I M
Nr. 603, datë 2.11.2001

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 479, DATË 31.8.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRGATITJEN DHE REALIZIMIN E KONTRATËS SË
KONCENSIONIT PËR NDËRTIMIN E TERMINALIT TË RI TË PASAGJERËVE NË
AEROPORTIN E RINASIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7973, datë 26.7.2005 “Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.479, datë 31.8.2000 të Këshillit të Ministrave bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1 të shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Objekt i koncensionit të jenë edhe elementët e tjerë infrastrukturorë, shërbimet aeroportuale dhe joaeroportuale, sipas përcaktimit të masterplanit të zhvillimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Rinasit.”.

2. Në pikën 3 rreshti i parë, pas fjalëve “...të ri të pasagjerëve...”, të shtohen fjalët “dhe elementëve të tjerë infrastrukturorë, shërbimeve aeroportuale dhe joaeroportuale...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.166, datë 12.7.2001

PËR SHPALLJEN E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZONËS ZGJEDHORE NR.29

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i mbledhur sot më datë 12.7.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Gasper Kokaj	Zëvendëskryetar
Tomor Malaj	Anëtar
Pandeli Varfi	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Igli Toska	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar

pasi shqyrtoi procesverbalet e vendimet e prura nga KZZ nr.29, bazuar në nenin 18 pika 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë",

V E N D O S I:

Të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.29, duke njohur si fitues kandidatin për deputet të PSSH z.Bardhyl Agasi.

Zëvendëskryetari	Kryetari
Gasper Kokaj	Ilirjan Celibashi

V E N D I M
Nr.197, datë 24.7.2001

PËR SHPALLJEN E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZONËS ZGJEDHORE NR.22

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i mbledhur sot më datë 24.7.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Gasper Kokaj	Zëvendëskryetar
Tomor Malaj	Anëtar
Pandeli Varfi	Anëtar
Igli Toska	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar

pasi shqyrtoi procesverbalet e vendimet e prura nga KZZ nr.22, bazuar në nenin 18 pika 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë",

V E N D O S I:

Të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.22, duke njohur si fitues kandidatin e pavarur për deputet z.Dilaver Qesja.

Zëvendëskryetari	Kryetari
Gasper Kokaj	Ilirjan Celibashi

V E N D I M
Nr.198, datë 24.7.2001

Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zonës zgjedhore nr.86

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i mbledhur sot më datë 24.7.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Gasper Kokaj	Zëvendëskryetar
Tomor Malaj	Anëtar
Pandeli Varfi	Anëtar
Igli Toska	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar

pasi shqyrtoi procesverbalet e vendimet e prura nga KZZ nr.86, bazuar në nenin 18 pika 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë",

V E N D O S I:

Të shpallë rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.86, duke njohur si fitues kandidatin për deputet të PSSH z.Maço Lakrori.

Zëvendëskryetari	Kryetari
Gasper Kokaj	Ilirjan Celibashi

V E N D I M
Nr.203, datë 25.7.2001

PËR SHPALLJEN E REZULTATIT TË ZONËS ZGJEDHORE NR.2

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i mbledhur sot më datë 25.7.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Gasper Kokaj	Zëvendëskryetar
Tomor Malaj	Anëtar
Pandeli Varfi	Anëtar
Igli Toska	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar

pasi shqyrtoi procesverbalet e vendimet e prura nga KZZ nr.2, bazuar në nenin 18 pika 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë",

V E N D O S I:

Të shpallë rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.2, duke njohur si fitues kandidatin për deputet z.Lekë Çukaj, përfaqësues i subjektit zgjedhor të PSSH.

Zëvendëskryetari	Kryetari
Gasper Kokaj	Ilirjan Celibashi

V E N D I M
Nr.213, datë 2.8.2001

PËR SHPALLJEN E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZONËS ZGJEDHORE NR.4

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, asistuar nga sekretarja Merita Dulaku në mbledhjen e tij të datës 2.8.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Gaspar Kokaj	Zëvendëskryetar
Tomor Malaj	Anëtar
Pandeli Varfi	Anëtar
Igli Toska	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar

MORI NË SHQYRTIM ÇËSHTJEN ME:

Objekt: Shpalljen e rezultatit përfundimtar të zonës zgjedhore nr.4.
Baza Ligjore: Neni 18, pika 1 dhe pika 4, të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 "Për kodin zgjedhor të Republikës së Shqipërisë",
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur;

KONSTATOI SE:

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nga ana e kandidatit për deputet në zonën njëemërore nr.4 z.Ndrek Rukaj, është paraqitur tërheqja nga kandidimi, me pretendimin se gara është e pandershme dhe se është cënuar personaliteti i tij si kandidat.

Z.Ndrek Rukaj, në renditjen e kandidatëve, sipas votave të fituara në këtë zonë zgjedhore, renditet e dyti pas kandidatit Valentin Palaj. Pas largimit të z.Rukaj nga kandidimi, diferenca ndërmjet kandidatit Valentin Palaj dhe kandidatëve të tjerë është shumë e madhe dhe nuk ndikon në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në këtë zonë zgjedhore.

Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çmon se pas tërheqjes nga kandidimi për deputet të z.Ndrek Rukaj mund të shpallet rezultati përfundimtar i zgjedhjeve në këtë zonë zgjedhore.

PËR SA MË SIPËR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 18 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Për kodin zgjedhor të Republikës së Shqipërisë"

V E N D O S I:

Të shpallë rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.4, duke njohur si fitues kandidatin për deputet z.Valentin Palaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Zëvendëskryetari	Kryetari
Gaspar Kokaj	Ilirjan Celibashi

V E N D I M
Nr.215, datë 4.8.2001

PËR SHPALLJEN E REZULTATIT PËR VOTIMET PËR DEPUTETË TË LISTAVE SHUMEMËRORE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN PËR VITIN 2001

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i mbledhur sot më datë 4.8.2001, me pjesëmarrjen e:

Iirjan Celibashi	Kryetar
Pandeli Varfi	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar
Igli Toska	Anëtar

pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga komisionet e zonave zgjedhore në zbatim të nenit 18 pika 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë",

V E N D O S I:

- 1.Të shpallë rezultatin e votimit për deputetë të listave shumëmemërore për partitë politike dhe koalicionet sipas tabelës bashkëngjitur.
- 2.Pjesë të këtij vendimi janë dhe vendimet e marra për këtë votim për çdo zonë zgjedhore.

KRYETARI
Iirjan Celibashi

Rezultatet e votimit për partitë politike
dhe koalicionet për 100 zona zgjedhore
Numri i zgjedhësve 2.499.238
Vota të vlefshme 1.323.900
Vota të pavlefshme 49.310
Pjesëmarrja në votime 54.95 %
Pragu 33.098

25	Partia Socialiste e Shqipërisë	PS	549.589	41,513 %
11	Partia Demokratike + PLL + PR + PBK + PBL + (BF)	PD + BF	487.314	36,809 %
10	Partia Demokratike	PD	67.349	5,087 %
24	Partia Socialdemokrate	PSD	48.253	3,645 %
9	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	PBDNJ	34.607	2,614 %
1	Partia Agrare e Shqipërisë	PASH	33.993	2,568 %
2	Partia Aleanca Demokratike	AD	33.718	2,547 %
12	Partia Demokristiane e Shqipërisë	PDK	13.643	1,031 %
15	Partia Komuniste Shqiptare	PKSH	12.176	0,920 %
26	Partia Socialkristiane e Shqipërisë	PSKSH	9.072	0,685 %
5	Partia Bashkimi Demokrat	PBDSh	8.029	0,606 %
6	Partia Bashkimi Demokristian Shqiptar	PBDKSH	2.997	0,226 %
19	Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare	PLPSH	2.950	0,223 %
16	Partia Komunistëve të Bashkuar të Shqipërisë	PKBSH	2.902	0,219 %
4	Partia Bashkësia Kombëtare Shqiptare	PBKS	2.492	0,188 %
28	Partia e Unitetit Kombëtar	PUK	2.433	0,184 %
7	Partia Bashkimi Republikan Shqiptar	PBRSH	2.083	0,157 %
21	Partia Lidhja Kombëtare Shqiptare	PLKSH	1.854	0,140 %
3	Partia Alternativa Liberale	PALSH	1.619	0,122 %

8	Partia Biznesi Shqiptar	PBSH	1. 568	0,118%
18	Partia Lëvizja Monarkiste Demokrate Shqiptare	PL.Mona	999	0,075%
23	Partia Reformatore Demokratike Shqiptare	PRDSH	871	0,066%
27	Partia Shqiptare Ambientaliste	PSHA	695	0,052%
13	Partia Emigracioni Shqiptar	PESH	674	0,051%
17	Partia Konservatore Shqiptare	P.KONS	592	0,045%
14	Partia Forca Albania	PFA	580	0,044%
20	Partia Lidhja Fshatare	PLFSH	491	0,037%
22	Partia Pajtimit Kombëtar Shqiptar	PPK	357	0,027%

Tiranë, 4.8.2001

MENDIMI I PAKICËS

Në lidhje me vendimin për shpalljen përfundimtare të votimit për listat shumëmemërore, jam pjesërisht kundër pasi në vendimet që kemi marrë zonë për zonë në lidhje me përqindjet e dala nga votimi i listave shumëmemërore në një pjesë të zonave kam qenë kundër pasi kam vërejtur ndërhyrje në proces jashtë kuadrit ligjor dhe çrregullime që kanë ndikuar negativisht në rezultatin e zgjedhjeve.

Përkatësisht këto zona janë:

Zona 2	Zona 33
Zona 18	Zona 40
Zona 19	Zona 49
Zona 20	Zona 60
Zona 24	Zona 67
Zona 26	Zona 90

Mendoj që rezultatet e këtyre 12 zonave ndikojnë në përqindjet e dala në vendimin përfundimtar për shpalljen e rezultateve për çdo subjekt zgjedhor dhe, për këtë arsye, gjykoj që unë të jem pjesërisht kundër shifrave të dala në tabelën bashkëngjitur vendimit.

Klement Zguri

V E N D I M Nr.217, datë 7.8.2001

PËR SHPALLJEN E REZULTATIT TË ZONËS ZGJEDHORE NR.14

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, asistuar nga sekretarja Merita Dulaku, në mbledhjen e tij të datës 7.8.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Gaspar Kokaj	Zëvendëskryetar
Tomor Malaj	Anëtar
Pandeli Varfi	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar
Igli Toska	Anëtar

MORI NË SHQYRTIM ÇËSHTJEN ME:

Objekt: Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.14.

Baza Ligjore: Neni 18, pika 4, të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur:

KONSTATOI SE:

Komisioni i zonës zgjedhor nr.14, me vendimin nr.17, datë 23.7.2001, ka shpallur deputet të drejtpërdrejtë në zonën zgjedhore nr.14, z.Ndre Legisi, përfaqësues i Partisë Socialiste Shqiptare. Nga shqyrtimi i tabelës së rezultateve të zonës zgjedhore nr.14 Model 39/1 u vërejt se diferenca ndërmjet kandidatit të parë dhe kandidatit të dytë, ishte 441 vota, ndërkohë që numri i fletëve votimi të pavlefshme është 503. Meqenëse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gjendej përpara kërkesave të rinumërimit, të parashikuar nga neni 108 i Kodit Zgjedhor, vendosi të shpallë rezultatin e zgjedhjeve për këtë zonë zgjedhore, pasi të kryhej procesi i rinumërimit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mirditë, me vendimin nr.101, datë 25.7.2001, ka vendosur të kthejë pa veprime kërkesën e paraqitur nga zëvendëskryetari i KZZ-së nr.14 dhe përfaqësuesit të kandidatit, z.Llesh Cupi për kryerjen e rinumërimit nga ana e kësaj Gjykate. Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim nga z.Kolin Gjoka, kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.14 në Gjykatën e Apelit të Tiranës. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.104, datë 2.8.2001, ka vendosur mospranimin e ankimit kundër vendimit nr.101, datë 25.7.2001, të Gjykatës së Shkallës së Parë Mirditë.

Gjithashtu, kandidati për deputet në këtë zonë zgjedhore z.Kolin Gjoka ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve një këkesë ankimore në të cilën kërkohej kryerja e procedurave të rinumërimit. Për këtë arsye, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.201, datë 31.7.2001, ka vendosur t'i kërkojë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë, kryerjen e procedurave të rinumërimit. Gjykata e Rrethit Mirditë me shkresën nr.137/1, ka kthyer pa veprim vendimin nr.201, datë 31.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me arsyetimin se në bazë të nenit 36, paragrafi 3 i Kodi i Procedurës Civile, asnjë institucion nuk ka të drejtë të shqyrtojë mosmarrëveshjet të cilat janë duke u shqyrtuar nga gjykatat.

Në këto kushte, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çmon se nga ana e kërkuesit janë konsumuar instrumentat ligjore të ankimit të parashikuara nga Kodi Zgjedhor. Duke qenë se vendimi i Gjykatës së Apelit është i formës së prerë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për këtë zonë zgjedhore.

PËR SA MË SIPËR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 18 pika 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Për kodin zgjedhor të Republikës së Shqipërisë",

V E N D O S I:

Të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.14, duke njohur si fitues kandidatin për deputet z.Ndre Legisi, përfaqësues i Partisë Socialiste Shqiptare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Zëvendëskryetar
Gasper Kokaj

Kryetari
Ilirjan Celibashi

V E N D I M
Nr.226, datë 20.8.2001

PËR SHPALLJEN E REZULTATIT TË ZONËS ZGJEDHORE NR.82

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i mbledhur sot më datë 20.8.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Gasper Kokaj	Zëvendëskryetar
Tomor Malaj	Anëtar
Pandeli Varfi	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Igli Toska	Anëtar

pasi shqyrtoi procesverbalet e vendimet e prura nga KZZ nr.82, bazuar në nenin 18 pika 4 të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë",

V E N D O S I:

Të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.82, duke njohur si fitues kandidatin për deputet të PSSH z.Rrahmi Mehmetllari.

Zëvendëskryetar	Kryetari
Gasper Kokaj	Ilirjan Celibashi

V E N D I M
Nr.227, datë 21.8.2001

**PËR NUMRIN E VENDEVE QË U PËRKASIN PARTIVE POLITIKE DHE
KOALICIONEVE NGA NDARJA E MANDATEVE PLOTËSUESE NË ZGJEDHJET
PËR KUVENDIN PËR VITIN 2001**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 21.8.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Gaspër Kokaj	Zëvendëskryetar
Pandeli Varfi	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar
Igli Toska	Anëtar

MORI NË SHQYRTIM ÇËSHTJEN ME:

Objekt: Për numrin e vendeve që u përkasin partive politike dhe koalicioneve nga ndarja e mandateve plotësuese në zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001.

Baza Ligjore: Neni 64 pika 2 e Kushtetutës së Shqipërisë dhe neni 18 pika 4, dhe 66, i ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë."

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur:

KONSTATOI SE:

Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 64 pika 2 të saj, ka përcaktuar se numri i përgjithshëm i deputetëve të çdo partie dhe/ose koalicioni partish përcaktohet në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra prej tyre në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve. Në zbatim të kësaj dispozite Kushtetuese, ligjvënësi ka sanksionuar në nenin 66 të Kodit Zgjedhor rregullat për ndarjen e dyzet mandateve plotësuese ndërmjet partive dhe koalicioneve të partive, të cilat duhet të zbatohen në zgjedhjet për Kuvendin. Nga zbatimi i këtyre rregullave rezultoi se numri i vendeve që i takon secilës parti apo koalicion partish që kanë kaluar pragun prej 2.5% apo 4% në zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001 të jetë si vijon:

- Koalicioni "Bashkimi për Fitore" 21 vende
- Partia Demokrate 6 vende
- Partia Socialdemokrate 4 vende
- Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut 3 vende
- Partia Agrare Shqiptare 3 vende
- Partia Aleanca Demokratike 3 vende

PËR SA MË SIPËR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 64 të Kushtetutës dhe të neneve 18 pika 4 dhe 66 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Të miratojë numrin e vendeve që i përket çdo partie apo koalicioni partish, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001 si vijon:

- Koalicioni "Bashkimi për Fitore" 21 vende
- Partia Demokrate 6 vende
- Partia Socialdemokrate 4 vende
- Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut 3 vende
- Partia Agrare Shqiptare 3 vende
- Partia Aleanca Demokratike 3 vende

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Zëvendëskryetari

Gaspër Kokaj

Kryetari

Illirjan Celibashi

Rezultatet e votimit për partitë politike dhe koalicionet për 100 zona zgjedhore

Numri i zgjedhësve 2,499,238

Vota të vlefshme 1,323,900

Vota të pavlefshme 49,310

Pjesëmarrja në votime 54,95%

Pragu 33,098

25	Partia Socialiste e Shqipërisë	PS	549.589	41,513%
11	Partia Demokratike + PLL + PR + PBK + PBL + (BF)	PD + BF	487.314	36,808%
10	Partia Demokrate	PD	67.349	5,087%
24	Partia Socialdemokrate	PSD	48.253	3,645%
9	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	PBDNJ	34.607	2,614%
1	Partia Agrare e Shqipërisë	PASH	33.993	2,568%

2	Partia Aleanca Demokratike	AD	33.718	2,547%
12	Partia Demokratiane e Shqipërisë	PDK	13.643	1,031%
15	Partia Komuniste Shqiptare	PKSH	12.176	0,920%
26	Partia Socialkristiane e Shqipërisë	PSKSH	9.072	0,685%
5	Partia Bashkimi Demokrat	PBDSH	8.029	0,606%
6	Partia Bashkimi Demokratian Shqiptar	PBDKSH	2.997	0,226%
19	Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare	PLPSH	2.950	0,223%
16	Partia e Komunistëve të Bashkuar të Shqipërisë	PKBSH	2.902	0,219%
4	Partia Bashkësia Kombëtare Shqiptare	PBKSH	2.492	0,188%
28	Partia e Unitetit Kombëtar	PUK	2.433	0,184%
7	Partia Bashkimi Republikan Shqiptar	PBRSH	2.083	0,157%
21	Partia Lidhja Kombëtare Shqiptare	PLKSH	1.854	0,140%
3	Partia Alternativa Liberale	PALSH	1.619	0,122%
8	Partia Biznesi Shqiptar	PBSH	1.568	0,118%
18	Partia Lëvizja Monarkiste Demokratike Shqiptare	PL.Mona	999	0,075%
23	Partia Reformatore Demokratike Shqiptare	PRDSH	871	0,066%
27	Partia Shqiptare Ambientaliste	PSHA	695	0,052%
13	Partia Emigracioni Shqiptar	PESH	674	0,051%
17	Partia Konservatore Shqiptare	P.KONS	592	0,045%
14	Partia Forca Albania	PFA	80	0,044%
20	Partia Lidhja Fshatare	PLFSH	491	0,07%
22	Partia e Pajtitit Kombëtar Shqiptar	PPK	357	0,027%

V E N D I M
Nr.228, datë 21.8.2001

PËR SHPALLJEN E LISTËS SË DEPUTETËVE TË PARTISË SOCIALDEMOKRATE, TË CILËT PËRFITOJNË NGA NDARJA E MANDATEVE PLOTËSUESE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN PËR VITIN 2001

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjet e tij datës 21.8.2001, me pjesëmarrjen e:

Iirjan Celibashi	Kryetar
Gasper Kokaj	Zëvendëskryetar
Pandeli Varfi	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar
Igli Toska	Anëtar

MORI NË SHQYRTIM ÇËSHTJEN ME:

Objekt: Për shpalljen e listës së deputetëve të Partisë Socialdemokrate, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001.

Baza Ligjore: Neni 18 pika 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur:

KONSTATOI SE:

Partia Socialdemokrate, në zbatim të neneve 81, 82 e 83 të Kodit Zgjedhor, në datë 2.6.2001, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve listën shumëmemërore të kësaj partie. Kjo listë është shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.784, datë 2.6.2001 "Për rregjistrimin e listës shumëmemërore të Partisë Socialdemokrate, për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001".

Nga ndarja e mandateve plotësuese për deputetë, të cilët i përkasin një partie apo koalicionit të partive, në bazë të përqindjes që Partia Socialdemokrate ka marrë në zgjedhjet për Kuvendin, llogaritet të marrë 4 deputetë nga numri i përgjithshëm i mandateve plotësuese. Në bazë të listës shumëmemërore, të dorëzuar dhe të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfitojnë nga kjo listë të gjithë kandidatët me numër rendor nga 1 deri në 4.

PËR SA MË SIPËR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 18 pika 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë".

V E N D O S I:

1. Të shpallë listën e deputetëve të Partisë Socialdemokrate, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001, si vijon:

1. z. Skënder Gjinushi
 2. z. Paskal Milo
 3. z. Gaqo Apostoli
 4. z. Engjëll Bejtaj
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Zëvendëskryetari
Gaspër Kokaj

Kryetari
Ilirjan Celibashi

V E N D I M

Nr.229, datë 21.8.2001

**PËR SHPALLJEN E LISTËS SË DEPUTETËVE TË PARTISË ALEANCA
DEMOKRATIKE, TË CILËT PËRFITOJNË NGA NDARJA E MANDATEVE PLOTËSUESE
PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN PËR VITIN 2001**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 21.8.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Gasper Kokaj	Zëvendëskryetar
Pandeli Varfi	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar
Igli Toska	Anëtar

MORI NË SHQYRTIM ÇËSHTJEN ME:

Objekt: Për shpalljen e listës së deputetëve të Partisë Aleanca Demokratike, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001.

Baza ligjore: Neni 18 pika 4 e ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur:

KONSTATOI SE:

Partia Aleanca Demokratike, në zbatim të neneve 81, 82 e 83 të Kodit Zgjedhor, në datë 2.6.2001, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve listën shumëmemërore të kësaj partie.

Kjo listë është shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.783, datë 2.6.2001 "Për rregjistrimin e listës shumemërore të Partisë Aleanca Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001".

Nga ndarja e mandateve plotësuese për deputetë të cilët i përkasin një partie apo koalicionit të partive, në bazë të përqindjes që Partia Aleanca Demokratike ka marrë në zgjedhjet për Kuvendin, llogaritet të marrë 3 deputetë nga numri i përgjithshëm i mandateve plotësuese. Në bazë të listës shumemërore të dorëzuar dhe të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfitojnë nga kjo listë të gjithë kandidatët me numër rendor nga 1 deri në 3.

PËR SA MË SIPËR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 18 pika 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë".

V E N D O S I:

1. Të shpallë listën e deputetëve të Partisë Aleanca Demokratike, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001, si vijon:

1.z.Arben Imami

2.z.Neritan Ceka

3.z.Preç Zogaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Zëvendëskryetari
Gaspër Kokaj

Kryetari
Ilirjan Celibashi

V E N D I M

Nr.230, datë 21.8.2001

PËR SHPALLJEN E LISTËS SË DEPUTETËVE TË PARTISË DEMOKRATE, TË CILËT PËRFITOJNË NGA NDARJA E MANDATEVE PLOTËSUESE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN PËR VITIN 2001

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 21.8.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Gasper Kokaj	Zëvendëskryetar
Pandeli Varfi	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar
Igli Toska	Anëtar

MORI NË SHQYRTIM ÇËSHTJEN ME:

Objekt: Për shpalljen e listës së deputetëve të Partisë Demokratike, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001.

Baza Ligjore: Neni 18 pika 4 të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur:

KONSTATOI SE:

Partia Demokratike, në zbatim të neneve 81, 82 e 83 të Kodit Zgjedhor, në datë 4.6.2001, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve listën shumemërore të kësaj partie. Kjo listë është shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.796, datë 5.6.2001 "Për regjistrimin e listës shumemërore të Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001".

Nga ndarja e mandateve plotësuese për deputetë, të cilët i përkasin një partie apo koalicionit të partive, në bazë të përqindjes që Partia Demokratike ka marrë në zgjedhjet për Kuvendin, llogaritet të marrë 6 deputetë nga numri i përgjithshëm i mandateve plotësuese. Në bazë të listës shumemërore të dorëzuar dhe të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfitojnë nga kjo listë të gjithë kandidatët me numër rendor nga 1 deri në 6. Në kërkesën për depozitimin e listës shumemërore Partia Demokratike ka përcaktuar se përzgjedhja e kandidatëve për listën shumemërore, bëhet mbi bazën e mesatares së përqindjeve të votave që merr secili kandidat, si dhe me atë të subjektit politik në zonën zgjedhore përkatëse. Nga zbatimi i kësaj formule, gjashtë kandidatët të cilët kanë përqindjen më të lartë të votave janë si vijon:

- Nard Ndoka, kandidat në zonën zgjedhore nr.3, me 10, 51%
- Jak Ndokaj, kandidat në zonën zgjedhore nr.44, me 9, 26%
- Qazim Tepshi, kandidat në zonën zgjedhore nr.29, me 8, 25%;
- Saimir Curri, kandidat në zonën zgjedhore nr.45, me 7, 70%;
- Dashamir Shehi, kandidat në zonën zgjedhore nr.38, me 7, 06%;
- Ilirian Berzani, kandidat në zonën zgjedhore nr.26, me 6, 83%;

PËR SA MË SIPËR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 18 pika 4, të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë",

V E N D O S I:

1.Të shpallë listën e deputetëve të Partisë Demokratike, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001, si vijon:

- Nard Ndoka
- Jak Ndokaj
- Qazim Tepshi
- Saimir Curri
- Dashamir Shehi
- Ilirian Berzani

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Zëvendëskryetari
Gaspër Kokaj

Kryetari
Ilirjan Celibashi

V E N D I M
Nr.231, datë 21.8.2001

**PËR SHPALLJEN E LISTËS SË DEPUTETËVE TË PARTISË AGRARE TË SHQIPËRISË,
TË CILËT PËRFITOJNË NGA NDARJA E MANDATEVE PLOTËSUESE
PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN PËR VITIN 2001**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 21.8.2001, me pjesëmarrjen e:

Iirjan Celibashi	Kryetar
Gaspër Kokaj	Zëvendëskryetar
Pandeli Varfi	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar
Igli Toska	Anëtar

MORI NË SHQYRTIM ÇËSHTJEN ME:

OBJEKT:Për shpalljen e listës së deputetëve të Partisë Agrare të Shqipërisë, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001.

BAZA LIGJORE: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur:

KONSTATOI SE:

Partia Agrare e Shqipërisë, në zbatim të neneve 81, 82 e 83 të Kodit Zgjedhor, në datë 2.6.2001, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve listën shumëmemërore të kësaj partie. Kjo listë është shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.781, datë 2.6.2001 “Për rregjistrimin e listës shumëmemërore të Partisë Agrare të Shqipëri për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001”.

Nga ndarja e mandateve plotësuese për deputetë, të cilët i përkasin një partie apo koalicionit të partive, në bazë të përqindjes që Partia Agrare e Shqipërisë ka marrë në zgjedhjet për Kuvendin, llogaritet të marrë 3 deputetë nga numri i përgjithshëm i mandateve plotësuese. Në bazë të listës shumëmemërore të dorëzuar dhe të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfitojnë nga kjo listë të gjithë kandidatët me numër rendor nga 1 deri në 3.

Partia Agrare e Shqipërisë, me shkresën nr.247/1 prot. datë 1.8.2001, ka vënë në dijeni Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për dorëheqjet që kanë dhënë nga kandidimi për deputet nga lista shumëmemërore 20 kandidatë të kësaj partie si më poshtë:

1. z.Edlir Petanaj
2. z. Ymer Tola
3. z. Ramazan Hasa
4. z. Pëllumb Abeshi
5. z. Resmi Osmani
6. z. Shahin Bejdaj
7. z. Fadil Kukaj
8. z. Muzafer Kraja
9. z.Zeqir Basha
10. z. Paqësor Cane
11. z. Petrit Gjoni
12. z. Vladimir Lleshaj
13. z. Arben Shytaj
14. z. Beqir Elezi
15. z. Vezir Metaj

- 16. z. Mylazim Tusku
- 17. z. Selim Kolushi
- 18. z. Pashk Aliaj
- 19. zj. Taire Bozhani
- 20. z. Kujtim Nanaj

Duke qenë se numri 1 dhe 3 i listës shumemërore nuk ndryshojnë, pas dorëheqjeve të paraqitura z. Refet Dervina, i cili ka numrin rendor 23, llogaritet i treti në listë shumemërore të kandidatëve për deputetë të kësaj partie.

PËR SA MË SIPËR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 18 pika 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë:

V E N D O S I:

1. Të shpallë listën e deputetëve të Partisë Agrare të Shqipërisë, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001 si vijon:

- 1. z. Lufter Xhuveli
 - 2. z. Ndue Preka
 - 3. z. Refet Dervina
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Zëvendëskryetari	Kryetari
Gaspër Kokaj	Ilirjan Celibashi

V E N D I M Nr.232, datë 21.8.2001

PËR SHPALLJEN E LISTËS SË DEPUTETËVE TË KOALICIONIT POLITIK “BASHKIMI PËR FITORE”, TË CILËT PËRFITTOJNË NGA NDARJA E MANDATEVE PLOTËSUESE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN PËR VITIN 2001

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 21.8.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Gaspër Kokaj	Zëvendëskryetar
Pandeli Varfi	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar
Igli Toska	Anëtar

MORI NË SHQYRTIM ÇËSHTJEN ME:

OBJEKT: Për shpalljen e listës së deputetëve të koalicionit politik “Bashkimi për Fitore”, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001.

BAZA LIGJORE: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur.

KONSTATOI SE:

Koalicioni politik “Bashkimi për Fitore”, në zbatim të neneve 81, 82 e 83 të Kodit Zgjedhor, në datë 2.6.2001, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve listën shumemërore të këtij koalicioni. Kjo listë është shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.794, datë 4.6.2001 “Për rregjistrimin e listës shumemërore të koalicionit “Bashkimi për Fitore” për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001”.

Nga ndarja e mandateve plotësuese për deputetë të cilët i përkasin një partie apo koalicioni të partive, në bazë të përqindjes që koalicioni “Bashkimi për Fitore” ka marrë zgjedhjet për Kuvendin, llogaritet që ky koalicion të marrë 21 deputetë nga numri i përgjithshëm i mandateve plotësuese. Në bazë të listës shumemërore të dorëzuar dhe të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfitojnë nga kjo listë të gjithë kandidatët me numër rendor nga 1 deri në 21.

Koalicioni Bashkimi për Fitore, me shkresën nr.8913, prot, datë 29.7.2001, ka vënë në dijeni Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për dorëheqjen që kandidati i këtij koalicioni z. Abaz Ermenji, përfaqësues i subjektit politik të Ballit Kombëtar, ka dhënë dorëheqjen nga kandidimi për deputet nga lista shumemërore e këtij koalicioni.

Në bazë të marrëveshjes së koalicionit të depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në listën shumemërore të koalicionit, kandidatët me numër rendor 5, 9, 13, 17 dhe 32 janë kandidatë të Partisë Balli Kombëtar. Meqenëse kandidati i kësaj partie ka dhënë dorëheqjen dhe në bazë të marrëveshjes ky vend i takon sërishmi Partisë Balli Kombëtar, përfaqësuesit e koalicionit kanë propozuar që në listën shumemërore të bëhen këto ndryshime:

Kandidati Shpëtim Rroqi nga numri rendor 9 kalon në numrin rendor 5;

Kandidati Uran Metko nga numri rendor 13 kalon në numrin rendor 9;

Kandidati Alfred Çako nga numri rendor 17 kalon në numrin rendor 13;

Kandidati Luan Myftiu nga numri rendor 32 kalon në numrin rendor 17.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi materialet e paraqitura, çmon se meqenëse sipas marrëveshjes së koalicionit, të gjitha këto ndryshime kanë të bëjnë dhe i përkasin vetëm Partisë Balli Kombëtar, atëherë ato mund të pranohen.

Gjithashtu, lista shumemërore e depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nuk do të llogariten në ndarjen e mandateve plotësuese kandidatët të cilët janë shpallur fitues në zonat zgjedhore njëmërore.

PËR SA MË SIPËR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 18 pika 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të shpallë listën e deputetëve të koalicionit politik “Bashkimi për Fitore” të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001 si vijon:

1. Ridvan Bode
2. Eqerem Spahiu
3. Fatmir Mediu
4. Shpëtim Rroqi
5. Jemin Gjana
6. Maksim Begeja
7. Uran Metko
8. Teodor Laço
9. Aleksandër Garuli
10. Alfred Çako
11. Bahri Kollcaku

12. Et'hem Fezollari
13. Robert Çeku
14. Luan Myftiu
15. Fatos Beja
16. Neritan Alibali
17. Sadedin Balla
18. Ilir Bano
19. Arjan Starova
20. Sokol Olldashi
21. Marjeta Pronjari

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Zëvendëskryetari
Gaspër Kokaj

Kryetari
Ilirjan Celibashi

V E N D I M
Nr.233, datë 21.8.2001

PËR SHPALLJEN E LISTËS SË DEPUTETËVE TË PARTISË BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT, TË CILËT PËRFITOJNË NGA NDARJA E MANDATEVE PLOTËSUESE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN PËR VITIN 2001

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 21.8.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Gaspër Kokaj	Zëvendëskryetar
Pandeli Varfi	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar
Igli Toska	Anëtar

MORI NË SHQYRTIM ÇËSHTJEN ME:

O B J E K T: Për shpalljen e listës së deputetëve të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001.

BAZA LIGJORE: Neni 18 pika 4 i ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur:

KONSTATOI SE:

Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, në zbatim të neneve 81, 82 e 83 të Kodit Zgjedhor, në datë 2.6.2001, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve listën shumëmemërore të kësaj partie. Kjo listë është shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.793, datë 4.6.2001 "Për regjistrimin e listës shumëmemërore të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001".

Nga ndarja e mandateve plotësuese për deputetë, të cilët i përkasin një partie apo koalicioni të partive, në bazë të përqindjes që Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut ka marrë në zgjedhjet për Kuvendin, llogaritet të marrë 3 deputetë nga numri i përgjithshëm i mandateve plotësuese. Në bazë të listës shumëmemërore të dorëzuar dhe të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfitojnë nga kjo listë të gjithë kandidatët me numër rendor nga 1 deri në 3.

Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, me shkresën nr.508, prot. datë 1.8.2001, ka vënë në dijeni Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për dorëheqjet që kanë dhënë nga kandidimi për deputet nga lista shumëmemërore 23 kandidatë të kësaj partie si më poshtë:

1. z. Ligoraq Karamelo
2. z. Kristo Goçi
3. z. Ziso Lluci
4. z. Leonard Solis
5. z. Gjergji Leka
6. z. Bajram Cena
7. z. Millan Vaso
8. z. Resul Domi
9. z. Vasil Bollano
10. z. Skënder Veliu
11. z. Vasil Jatru
12. z. Fuat Mehmeti
13. znj. Enkeleda Çela
14. z. Panajot Papa
15. znj. Tania Floqi
16. znj. Anita Gjoni
17. z. Anastas Buneci
18. z. Istref Pëllumbi
19. z. Jorgo Pandazo
20. z. Vladimir Verushi
21. z. Ibrahim Likzelia
22. z. Ilmi Ademi
23. z. Gjovalin Valca

Duke qenë se numri 1 dhe 2 i listës shumëmemërore nuk ndryshojnë, pas dorëheqjeve të paraqitura nga z. Arben Broja, i cili ka numrin rendor 25, llogaritet i treti në listën shumëmemërore të kandidatëve për deputetë të kësaj partie.

PËR SA MË SIPËR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 18 pika 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të shpallë listën e deputetëve të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001 si vijon:

1. z. Vasil Melo
 2. z. Vangjel Dule
 3. z. Arben Broja
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Zëvendëskryetari
Gaspër Kokaj

Kryetari
Ilirjan Celibashi

V E N D I M
Nr.256, datë 17.10.2001

**PËR SHPALLJEN E REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE PËR KRYETARIN E KOMUNËS
SË GOLAJT TË QARKUT TË KUKËSIT**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, asistuar nga sekretarja Merita Dulaku, në mbledhjen e tij të datës 17.10.2001, me pjesëmarrjen e:

Gaspër Kokaj	Zëvendëskryetar
Igli Toska	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar
Pandeli Varfi	Anëtar

MORI NË SHQYRTIM ÇËSHTJEN ME:

OBJEKTI: Shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kryetarin e Komunës së Golajt të Qarkut të Kukësit.

BAZA LIGJORE: Neni 18 pika 4 i ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

KONSTATOI SE:

Me dekretin nr.237, datë 20.9.2001 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar të Komunës Golaj”, Presidenti i Republikës ka caktuar datën 14.10.2001 si datë për zgjedhjet për kryetar të kësaj komune.

Më datën 14.10.2001 u zhvilluan zgjedhjet në këtë komunë dhe KZQV Golaj mbi bazën e tabelave të rezultateve të 16 qendrave të votimit ka sjellë pranë KQZ-së tabelën e rezultateve përfundimtare të njësisë zgjedhore për kryetarin e komunës Golaj dhe mbi bazën e kësaj table ka shpallur dhe kryetarin e kësaj komune z.Adem Ahmet Lala.

PËR SA MË SIPËR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 18 pika 1 i ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I:

Të shpallë rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për kryetarin e Komunës Golaj të Qarkut Kukës, duke njohur si fitues z.Adem Ahmet Lala.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Zëvendës	Kryetari
Gaspër	Kokaj

V E N D I M
Nr. 51, datë 16.7.2001

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT “LOBI VIZION”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “MRM” SH.P.K.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit, shoqëria “MRM” sh.p.k. licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Sefedin Çela

V E N D I M
Nr. 53, datë 16.7.2001

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT “TV ASPARAG”
SUBJEKTIT: Z. BARDHYL TOSKU

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit Z. Bardhyl Tosku licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
 2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- Kryetari
Sefedin Çela

V E N D I M
Nr. 54. datë 16.7.2001

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADIO VENDORE PRIVATE “RADIO 7”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “MEDIA J-7” SH.P.K.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, njëzëri

V E N D O S I:

1. T'i japë subjektit, shoqërisë "Media J-7" licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Sefedin Çela

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 6.11.2001
Doli nga shtypi më 7.11.2001

Tirazhi: 4210 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2001

Çmimi: 200 lekë